

INITIATIVA

Në kuadër të projektit “Promovimi i dialogut ndëretnik në vetëqeverisjen lokale”, i cili është financuar nga NED, janë realizuar iniciativa në komunat e Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore: Nëpërmjet nismave të përbashkëta, si projektet e mbrojtjes së mjedisit apo ngjarjet kulturore, komunitetet tregojnë se janë të afta të tejkalojnë dallimet dhe të punojnë së bashku për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

1.

MENAXHIMI I MJEDISIT PËR NJË TË NESËME TË PASTËR

Qëllimi i iniciativës së pastrimit ishte jo vetëm rregullimi i përbashkët i një pjese të rrethinës së rrugës kryesore, por edhe tërheqja e vëmendjes për problemin e deponimit jo të duhur të mbeturinave në rajonin e Mitrovicës dhe Zveçanit. Në këtë aktivitet u theksua se çështjet mjedisore prekin të gjithë, duke theksuar nevojën e bashkëpunimit për përbashkët të sfidave të përbashkëta. Promovimi i bashkëpunimit ndëretnik përmes iniciativave mjedisore jo vetëm që përfiton mjedisi, por gjithashtu nxit një ndjenjë të komunitetit dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve.

HAPAT DREJT TË ARDHMES SË PËRBASHKËT



Iniciativa për dialog ndëretnik në vetëqeverisje lokale

2



NJË PËRMBLEDHJE SATIRIKE E REALITETIT POLITIK

Performanca "Me çfarë, me kë në BE???" autori dhe regjisori Dragan Teshiq u shfaq në Qendrën Kulturore "Kadri Kadriu" si dhe në Qendrën Kulturore Private "Aquarius". Kjo satirë politike është shfaqja më e suksesshme e Teatrit nga Tuzla (Bosne e Hercegovinë) dhe ka tematikën për sfidat dhe mundësitë e mundshme shtetit për inkuadrim në Bashkimin Evropian.

Performanca ishte një mundësi që njerëzit nga komunitete të ndryshme të bashkoheshin dhe të shijonin të njëjtën ngjarje, duke i lidhur kështu këto dy qendra kulturore përmes një eksperience të përbashkët kulturore dhe mbështetjes për diversitetin kulturor.



DHURIMI I PAJISJEVE PËR SHKOLLËN FILLORE "ISA BOLETINI"

Shkolla fillore "Isa Boletini" është përzgjedhur nga OJQ ACDC, sepse është shkolla më e madhe në komunën e Zveçanit ku vijnë nxënësit nga komuniteti joshumicë në veri. U dhuruan pajisje audio, duke përfshirë miksera zëri, altoparantë zmadhues, kablo dhe montime, pasi shkolla e identifikoi si më të nevojshme.

3.



Gjithashtu, një nismë tjetër ka të bëjë me dhurimin e dverve të reja, të cilat do të përmirësojnë sigurinë dhe funksionalitetin e ambienteve të shkollës, duke krijuar kushte më të mira pune.

:Ky donacion i audio pajisjeve do të mundësojë shkollës të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe aktiviteteve të organizuara për nxënësit. Mikserat e zërimit, altoparantë, kablo dhe mbështetës, do të përmirësojnë sistemin e zërimit të shkollës, gjë që do të kontribuojë në një mbajtje më të mirë të ligeratave, prezantimeve dhe ngjarjeve kulturore.

4.

